



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALLAKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 1500 prot.

Ballsh, më 03.04.2024

VENDIM

Nr. 21, datë 28/03/2024

**“MBI MIRATIMIN E MARRJES ME QIRA TË PASURISË NR. 92/9, ZK 1566 , TOKË
ARË PËR NEVOJA TË BASHKISË MALLAKASTËR”**

Në zbatim të nenit 9, pika 1/1, gërma a, pika 1.6, gërma a, të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, shkresës me nr. 48 Prot., datë 19.03.2024 “Kërkesë” të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, administruar pranë bashkisë Mallakastër me nr. 1192 Prot., datë 19.03.2024, Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë Mallakastër me nr. 95, datë 19.03.2024 “Për ngritjen e grupit të punës për përcaktimin e hapësirës (pasurisë) për parkimin e mjeteve të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, Bashkia Mallakastër”, shkresës me nr. 1192/2 Prot., datë 21.03.2024 “Relacion” të grupit të punës,

VENDOSI

1. Marrjen me qira të pasurisë 92/9, ZK. 1566, me sipërfaqe 2250 m2, në pronësi të Z. Mehmet Likaj referuar dokumentacionit të pronësisë së paraqitur nga ana e qytetarit, për nevoja të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike për parkimin e mjeteve që ka në dispozicion (automjete, fadroma, skrepa etj).
2. Vlera e marrjes me qira e propozuar është 22 000 (njëzetë e dy mijë) në muaj.
3. Afati i marrjes me qira do të jetë 3 (tre) vjet me të drejtë rinovimi.
4. Ngarkohet Ndërmarrja e Shërbimeve Publike për ndjekje dhe zbatim.
5. Ky vendim shoqërohet me dokumentacionin bashkëlidhur.
6. Ky vendim hyn në fuqi sipas Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar

KRYETAR

Nexhmi Sulaj

